



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 64 par.2 pika a) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-000-79233, e datës 20.12.2020 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT-STATUTIN E KOMUNËS SË
LIPJANIT

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt-Statuti i Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt-Statut mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Projekt-Statutit të Komunës së Lipjanit ose në email adresën vlora.r.krasniqi@rks-gov.net së largu me datë 22.12.2021.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 1-020-72687
Lipjan, më 23.11.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

